

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 2920 Rep.

Nr. 985 Kol.



KONTRATË DHURIMI KUOTASH
Të shoqërisë "SAFETY ALBANIA" shpk.

Sot, në Tiranë, më datë 29 / 03 / 2019 (dy mijë e nëntëmbëdhjetë), përpara meje Julian Zhelegu, Noter pranë Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli ne Rr. "Pjetër Bogdani", nr. 13, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme, të cilat më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Dhurimi Kuotash.

Dhuruesi: **Z. Ndiriçim Hoxha**, shtetas shqiptar, lindur më 12.06.1978 në Canaj, Kukës dhe banues ne Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 028530696 dhe nr. personal H80612062N, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Dhuruesi");

dhe

Pranuesi: **Z. Edison Ceka**, shtetas shqiptar, lindur më 11.01.1981 në Zerqan, Dibër dhe banues ne Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 030634832 dhe nr. personal I10111089L, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Pranuesi i Dhurimit");

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

- a. Shoqëria "SAFETY ALBANIA" ShPK. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi L61311008J, me kapital themeltar 1.000 leke, me seli ne Tirane, Njësia Administrative Nr.6, Rruga Teodor Keko, Unaza e Re, Ndërtesë 2-kateshe, Nr. 147/4, Kati 1, (përballë Astirit);
- b. Siç rezulton nga ekstrakti i regjistrimit tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për të dhënat e Shoqërisë, Dhuruesi zotëron 1 (një) pjesë, që përfaqëson 50 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë (në vijim "Kuota");
- c. Dhuruesi i ka njoftuar Pranuesit te Dhurimit dëshirën e tij për te transferuar ne pronësi te Pranuesit te Dhurimit pjesën e kapitalit te zotëruar prej tij ne kapitalin e regjistruar të Shoqërisë dhe Pranuesi i Dhurimit ka pranuar të fitojë pronësisë mbi pjesët e kapitalit te ofruara nga Dhuruesi në Shoqëri, sipas parashikimeve te kësaj Kontrate;
- d. Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë dhe në përputhje me vendimin bashkëlidhur te asamblesë se ortakeve te Shoqërisë, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti i Kontratës

1.1 Dhuruesi transferon ne pronësi te Pranuesit te Dhurimit dhe Pranuesi i Dhurimit bie dakord që të fitojë nga Dhuruesi kuotën që Dhuruesi zotëron ne kapitalin themeltar te Shoqërisë dhe që përfaqëson 50% të kapitalin te regjistruar të Shoqërisë "SAFETY ALBANIA" ShPK. Pjesët e kapitalit që transferohen si më sipër janë të lira nga çdo barrë dhe të garantuara plotësisht sipas kushteve të kësaj Kontrate.

Neni 2 Transferimi

2.1 Kuota e zotëruar nga Dhuruesi ne kapitalin e shoqërisë transferohet ne favor te Pranuesit te Dhurimit, pa kundërshtim, pa pengje, barra apo kufizime te asnjë lloji.

Neni 3 Deklarimet dhe garancitë e Dhuruesit

3.1. Dhuruesi pranon se deklarimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:

- a. Dhuruesi ligjërisht e në momentin e nënshkrimit zotëron kuotat që do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'i transferuar këto kuota.
- b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Dhuruesi.
- c. Çdo deklarim apo garanci e dhënë nga Dhuruesi sipas kësaj Kontrate nuk përmban gabime materiale apo ometime.

Neni 4 Deklarimet e Pranuesit te Dhurimit

4.1. Pranuesi i Dhurimit pranon se deklarimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:

- a. Pranuesi i Dhurimit ka tagra të plota për të pranuar pjesët e kapitalit nga Dhuruesi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
- b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Pranuesi i Dhurimit.

Neni 5 Transferimi i të drejtave mbi pjesëmarrjen

5.1. Pronësia mbi kuotën / pjesën e kapitalit te Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së kuotave të Shoqërisë në favor të Pranuesit do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me Ligjin 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe Ligjin 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

5.2. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Dhuruesi humbet çdo të drejtë lidhur me 50% te pjesëmarrjes ne kapitalin e shoqërisë, që transferohen nëpërmjet kësaj Kontrate, përfshirë të drejtën e ushtrimit të votës në mbledhjet e Asamblesë dhe ndarjes së fitimeve që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Të gjitha të drejtat, që sipas Ligjit, burojnë nga zotërimi i 50% te kapitalit te shoqërisë te dhuruara sipas kësaj Kontrate, i transferohen Pranuesit te Dhurimit dhe ky i fundit bëhet titullar i vetëm i ligjshëm i pjesëmarrjes që përfaqëson 50% te kapitalit te shoqërisë;



5.3. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Dhuruesi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi pjesëmarrjen prej 50% të zotëruara, në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

5.4. Me lidhjen e kësaj Kontrate, Dhuruesi largohet nga Shoqëria, ndërsa Pranuesi i Dhurimit behet ortak i vetëm zotërues i 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 6

Të ndryshme

6.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çënohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

6.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të çdo dispozite tjetër rregulluese sipas legjislacionit shqiptar të aplikueshëm.


6.3. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6.4. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale.

Kjo Kontratë pasi iu lexua Palëve me zë të lartë e të qartë, nga unë Noteri, dhe pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve në praninë time dhe unë, Noteri, e vërtetoj atë sipas ligjit dhe për gjithë efektet e tij.

DHURUESI

Ndriçim Hoxha

Ndriçim Hoxha


PRANUESI I DHURIMIT

Edison Ceka

Edison CEKA


NOTERI

JULIAN ZHELEGU



ER
HNE
ELEGU
ELEGU

VENDIM
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE
“SAFETY ALBANIA” shpk.

Sot, me date 29 / 03 / 2019, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve të shoqërisë “SAFETY ALBANIA” Sh.P.K. (në vijim “Shoqëria”), shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi L61311008J, me kapital themeltar 1.000 leke, me seli në Tiranë, Njësia Administrative Nr.6, Rruga Teodor Keko, Unaza e Re, Ndërtesë 2-kateshe, Nr. 147/4, Kati 1, pasi shqyrtoi pikat e mëposhtme të rendit të dities:

1. Dhurimi i kuotave të kapitalit që zotërohen nga ortaku Ndriçim Hoxha të ortaku Edison Ceka;
2. Te tjera eventuale;

Në përputhje me dispozitat e Statutit të shoqërisë dhe Ligjin 9901/2008, të ndryshuar, Asambleja e Ortakeve, unanimisht vendosi:

VENDOSI:

1. Të miratoje transferimin e kuotave të zotëruara nga ortaku Ndriçim Hoxha (50% të kapitalit) në favor të ortakut Edison Ceka. Kontrata / marrëveshja përkatëse mund të konkludohet ndërmjet palëve pa kufizim me miratimin e këtij vendimi.
2. Ky Vendim depozitohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe Ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Duke mos pasur çështje të tjera për të diskutuar e vendosur, mbledhja e Asamblesë u mbyll.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE

Ndriçim Hoxha



Edison Ceka





REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20190329122356201
Data e Rezultatit të Kerkimit: 29.03.2019
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 12:23:56PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-168-3094
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

NDRICIM XHEMAL HOXHA
SAFETY ALBANIA SH.P.K.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L61311008J
2. Data e Regjistrimit	11/01/2016
3. Emri i Subjektit	SAFETY ALBANIA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	06/01/2016
6. Kohëzgjatja	Nga: 06/01/2016
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative Nr.6, Rruga Teodor Keko, Unaza e Re, Ndertese 2-kateshe, Nr 147/4, Kati 1, (perballë Astirit)
8. Kapitali	1.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Importi, eksporti, dhe tregtimi me shumice e pakice i materialeve e pajisjeve te ndertimit, brenda e dhe jashte vendit, per llogari te vete shoqerise apo te treteve, ku perfshihen vegla pune te te gjitha llojeve, pllaka, hidrosanitare, mishelatore, xham, duralumine, inerte, rere, kolle, boje, materiale adezive, hekur, tulla, gure, gure dekorative, gelqere, parafabrikate, llac, cemento, granile te fraksioneve te ndryshme si dhe cdo material tjeter qe nuk eshte permendur ketu por qe perdoret per qellime ndertimi; Prodhimi e perpunimi i materialeve qe perdoren ne ndertim. Import, eksport, tregtim me shumice e pakice te te gjitha llojeve te veshjeve dhe konfeksioneve, veshje pune, produkte lekure apo inkeliti, kepuce e veshje te tjera te kembeve, paisjeve te sigurimit teknik dhe sinjalistikes , fikese dhe paisje kundra zjarrit; Importimi dhe eksportimi e tregtimi i materialeve per sherbime publike, makineri pastrimi, filtrimi, ventilimi, gjeneratore e pjese te tyre, si dhe pajisjeve te ndryshme ne fushen e industrise e transportit; Ndertimin e rrugeve, kanalizimeve dhe objekteve civile dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

industriale (veprave publike te ndryshme); Mbjellje te pemeve dhe pastrim i pyjeve Transport kombetar e nderkombetar; Import, eksport, tregtim me shumice e pakice i pajisjeve industriale, elektrike, telefonike, elektroshtepiake, artikujve te mobilerise etj; Blerje, shitje, dhenie me qera e pasurive te luajtshme e te paluajtshme; Gjithashtu per te realizuar objektin e qellimit e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, qeradhenes apo dorezanes qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te saj e te lejueshme nga ligji shqiptar. Shoqeria mund te ngreje dhe mund te vere ne pune fabrika, kantjere si dhe stacione testimi dhe gjithashtu te transferoje keto ambiente dhe te ngreje ambiente te levizshme, ajo mundet te tregtojte prodhimet e veta ne tregun vendas dhe te huaj, te bleje dhe te marre me qira ambiente, magazina dhe vende prodhimi nga personat e trete dhe Institucionet Shteterore dhe ti zgjeroje keto ambiente ne perputhje ne objektin e veprimtarise se shoqerise. Te hyje ne partneritet me shoqerite e tjera apo individe brenda objektit te shoqerise apo te behet ortakt e veproje si perfaqesues ose te autorizojte perfaqesues dhe agjente si dhe te kontraktojte per keto ceshtje. Te bleje nga furnizues vendas apo te huaj makineri dhe pajisje dhe/ose mjete materiale per te prodhuar keto makinerie pajisje, te cilat nevojiten per realizimin e objektivave ekonomike dhe aktivitetit operacional te shoqerise. Te perfshihet ne aktivitetet kerkimore, zhvillimi, trajnimi, planifikim- projektim-zbatim dhe te tjera aktivitetete ngjashme. Te bleje, te shese, ndertoje, te jape e marre me kredi apo te perdore me cdo menyre te ligjshme te gjitha llojet e pronave te luajtshme e te paluajtshme, te vendose pengje, hipoteka, uzufukte apo cdo barre tjeter ne prona te veta te luajtshme e te paluajtshme si garanci te detyrimeve te veta apo edhe te treteve. Te marre polica sigurimi per te mbuluar asetet dhe operacione te veta. Te nxjerre, publikojte, shperndaje revista, broshura, libra, cdo dhe botime digitale ne lidhje me sektorin e vete dhe nepermjet sherbimeve te paleve te treta per keto botime. Te marre te gjitha llojet e kredive afat shkurter, afat mesem apo afat gjate nga ente vendase apo te huaja me apo pa titull financiare. Import-eksport, tregtim, transshipin, ndermjetesim dhe ekspozimin e te gjitha materialeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	ushtarake, armatimeve dhe municioneve te gjitha formave dhe te gjitha llojeve te lejuara nga dispozitat e Legjislacionit aktual Shqiptar. Shoqeria munde te merret me import, eksport, tregtime me shumice dhe pakice brenda vendit materiale dhe produkte, ushqimore, industriale, kimikate si dhe produktet te tjera. Projektme, studime fizibiliteti dhe ndertime tunelesh, pusesh, minierash, objektesh industriale dhe jo-industriale. Kerkimi, zbulimi, shfrytezimi dhe perpunimi i mineraleve te dobishme dhe tregtimi i tyre brenda dhe jashte vendit. Import eksport, tregtim me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale, materialet e ndertimit, produkteve bujqesore, blegtorale, ushqimore etj. Import dhe tregtim me shumice, pakice te automjeteve dhe mjeteve minierash, ndertimore te llojeve dhe tonazheve te ndryshme dhe pjeseve te kembimit per to.	
10. Administratori/ët	Edison Ceka	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 06/01/2016	Deri: 06/01/2021
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	NdrichimHoxha	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 500,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Ortakët	EdisonCeka	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 500,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: SAFETY ALBANIA Web site: www.safetyalbania.com	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	E-Mail: safetyalbania@gmail.com Telefon: +355682098376
16. Statusi:	Aktiv

Datë: 29/03/2019

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga Web